

Laboratorët e Departamentit të Termoenergjetikës dhe Energjisë së Ripërtëritshme kanë kryesisht të bëjnë me pasjisjet për:

Prodhimin e energjisë elektrike dhe termike nga burime të ndryshme të energjisë në pajisje të ndryshme si termocentrale me prodhim të ndarë dhe të kombinuar të energjisë, sisteme fotovoltaike, hidrocentrale të vogla, kolektorë termike diellore, kaldaja me lëndë djegëse të ndryshme dhe kaldaja elektrike, turbina të erës etc.

Efiçencën e shëndrrimit të energjisë nga një formë në formën tjetër p.sh fotovoltaiket bëjnë shëndrrimin e energjisë diellore në energji elektrike, hidrocentralet bëjnë shëndrrimin e energjisë hidraulike në energji elektrike, kolektorët diellor termike bëjnë shëndrrimin e energjisë diellore në energji termike, kaldajat e vogla dhe industriale përdoren për shëndrrimin e energjisë kimike të lëndës djegëse në energji termike në formë të ujit të ngrohtë dhe avullit të nevojshëm për procese të caktuara industriale, turbinave të erës të cilat e shëndrrojnë energjinë kinetike të erës në energji elektrike si dhe pompat termike për ngrohje dhe ftohje të cilat e rrisin aftësinë e performances me efiçence më të lartë termike të një burimi/greminë të energjisë termike, etj.

Mënyrën optimale të operimit të teknologjive të prodhimit, shëndrrimit dhe shfrytëzimit të energjisë. Me anë të pajisjeve laboratorike mobile të cilat i posedon Departamenti TER mund të bëhet vlerësimi i mënyrës së operimit të proceseve të ndryshme industriale, mbledhja e parametrave të nevojshëm për vlerësimin optimal të prodhimit, shpërndarjes dhe konsumit të energjisë në sektorët e ngrohjes, ftohjes, ndërtesave, industrisë, transportit dhe bujqësisë.



Inxhinierët e Termoenergjetikës dhe Energjisë së ripërtëritshme mund të ushtrojnë veprimtarinë e vet profesionale përveç tjerash në:

- Termoelektrocentrale me prodhim të kombinuar të energjisë elektrike dhe termike
- Ngrohoret e qyteteve
- Fabrika dhe Ndërmarrje për prodhimin, shfrytëzimin dhe akumulimin e energjisë nga pajisje të ndryshme konvencionale dhe të ripërtëritshme energjetike (kaldaja, këmbyes të nxehtësisë, enë nën shtypje, module fotovoltaike etj.),
- Ndërmarrje për projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të ngrohjes, ftohjes dhe klimatizimit
- Ndërmarrje për projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të termofikimit
- Ndërmarrje të cilat merren me projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve me shfrytëzimin efikas të energjisë në sektorët e ndryshëm si ngrohje, ftohje, transport, ndërtesa, industri dhe bujqësi etj
- Ndërmarrje të cilat merren me projektimin, prodhimin, dizajnimin e sistemeve të bazuara në burimet e ndara dhe të kombinuara të prodhimit të energjisë elektrike dhe termike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë
- Ndërmarrje lokale dhe ndërkombëtare të cilat merren me projektimin, dizajnimin dhe implementimin e sistemeve të qëndrueshme energjetike të cilat janë të bazuara në burimet e ripërtëritshme të energjisë, etj.

Lidhur me informatat tjera ju lutem na vizitoni në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ndërtesa e Fakultetit Teknik në Prishtinë, ose na kontaktoni në Tel. 038-552126, ose në <http://fim.uni-pr.edu>.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

Fakulteti i Inxhinierisë

Mekanike

Unë do të jem

student i Inxhinierisë

Mekanike!

Programi studimor:

Termoenergjetikë dhe Energji e

Ripërtëritshme



Bazat e themelimit të studimeve teknike, pra edhe të atyre të makinerisë, u vunë me hapjen e Shkollës së Lartë Teknike në Prishtinë, më 20 tetor 1961. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike mbush 61 vite pune dhe aktiviteti në aftësimin e kuadrove të reja nga lëmitë inxhinierisë mekanike, në hulumtimet fundamentale dhe të aplikueshme shkencore, në bashkëpunimin me ndërmarrjet inxhinierike dhe industriale si dhe me institucionet shtetërore dhe publike. Stafi akademik në Fakultetin tonë posedon kualifikimet më të larta për të gjitha format e punës akademike dhe shkencore. Studimet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike organizohen në nivelin Bachelor dhe Master në 6 programe mësimore:

- Programi Prodhimtari dhe Automatizim
- Programi **Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtërithme**
- Programi Komunikacion dhe Transport
- Programi Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti
- Programi Mekatronikë
- Programi Dizajn Inxhinierik dhe Automjete

Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, ushtrimeve numerike, ushtrimeve laboratorike, vizitave mësimore në terren, hulumtimeve, seminareve, etj.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike posedon salla të mësimi të standardeve të larta, salla kompjuterike, laboratorë, bibliotekën moderne, etj.


Të nderuar studentë të ardhshëm,

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike është institucion i cili synon zhvillimin dhe rritjen ekonomike të Kosovës.

Bëhuni pjesë e Programit tonë dhe na ndihmoni në realizimin e synimeve të Republikës tonë.

Mos hezitoni të na kontaktoni, vizitoni dhe të pyetni për çdo gjë që mund ju intereson!

Departamenti i Termoenergjetikës dhe Energjisë së Ripërtërithme (TER), është një program studimor në të cilin studentët njihen me mënyrat e prodhimit, shndërrimit, akumulimit dhe shfrytëzimit sa më eficient të energjisë nga burimet e ndryshme konvencionale dhe të ripërtërithme të energjisë me qëllim të arritjes së një qëndrueshmërie energjetike. Ky program bazohet në dy shtylla kryesore që kanë të bëjnë me Shkencat Termike me bazë termodinamiken e proceseve inxhinierike dhe Burimet e Ripërtërithme të Energjisë dhe mënyrat e integritit të tyre në sistemet aktuale dhe të avancuara energjetike.



Pas përfundimit të studimeve të nivelit Bachelor studentët do të jenë në gjendje:

- Të dallojnë pajisjet dhe proceset e prodhimit, shndërrimit, akumulimit dhe shfrytëzimit të energjisë nga burimet konvencionale dhe burimet e ripërtërithme të energjisë
- Të vlerësojnë rëndësinë ekonomike, teknike dhe mjedisore sa i përket integritit të energjive të ripërtërithme hibride në sisteme të vogla dhe të mëdha energjetike
- Kryejnë projektme të cilat kanë të bëjnë me vlerësimin e performacës energjetike në sektorin e ngrohjes, ftohjes, transportit, ndërtesave dhe industrisë
- Bëjnë dizajnimin dhe projektimin e sistemeve të ngrohjes, ftohjes, ventilimit dhe klimatizimit dhe energjive të ripërtërithme.

Departamenti TER është i akredituar për vitet akademike 2021-2024. Stafi i rregullt i Departamentit TER janë gjithsej gjashtë Professor, dy Asistent dhe një Laborant si dhe stafi i angazhuar për mbulimin e kërkesave arsimore dhe shkencore të departamentit në përbërje:

- Prof. Dr. Naser Sahiti
- Prof. Dr. Rexhep Selimaj
- Prof. Asoc. Dr. Fitore Avdullahu
- Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha
- Prof. Ass. Dr. Drenusha Krasniqi Alidema
- Prof. Ass. Dr. Drilon Meha
- Ass. Dr. Bukurije Hoxha
- Ass. Msc. Arlinda Bresa
- Ass. Msc. Arben Avdiu, Laborant.

Departamenti TER është i involvuar në zhvillimin e qëndrueshëm të politikave menaxhuese, shkencore dhe hulumtuese të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe me gjerë. I njëjti prezanton një sinergji të praktikave më të mira të Universiteteve lokale dhe ndërkombëtare të nevojshme për zhvillimin e kurrikulave të dobishme të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin dhe punësimin e studentëve për zgjidhjen e problemeve duke promovuar ide të reja për prodhimin, shndërrimin, akumulimin dhe shfrytëzimin e energjisë.. Në kuadër të këtyre Universiteteve janë: Friedrich-Alexander-Universität Erlangen-Nürnberg, Gjermani; Vienna University of Technology, Vjenë, Austri; University of Zagreb, Zagreb, Kroaci; Universiteti “S.s.Cyril and Methodius” Universiteti i Shkupit, Shkup, Maqedonia Veriore, Universiteti Politeknik i Tiranës, Tiranë, Shqipëri si dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë.

Fushat e avancuara të studimit të Departamentit TER fokusohen në zhvillimin e teknologjive të reja në sistemet e ngrohjes, ftohjes, ventilimit dhe klimatizimit si p.sh. këmbesit e nxehtësisë duke përdorur zgjidhje të reja inovativesistemet e operimit të teknologjive ekzistuese si p.sh. termocentraleve, sistemet e planifikimit, operimit dhe kursimit të energjisë në sistemet e ngrohjes dhe ftohjes qendrore në qytete, planifikimin dhe integrimin e energjive të ripërtërithme, planifikimin e sektorit të qëndrueshëm energjetike që përfshin sinergjinë optimale të shfrytëzimit të energjisë elektrike, ngrohjes, ftohjes, transportit, industrisë dhe bujqësisë, si dhe eficiency e energjisë në sektor të ndryshëm.